



Agjencia e Kosovës për Akreditim

POLITIKA E PRIVATËSISË



Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Politikat e privatësisë	4
3. Përgjegjësia dhe përpunimi i të dhënave personale	4
4. Kategoria e të dhënave të përpunuara.....	5
5. Përdorimi i të dhënave personale.....	5
6. Baza ligjore për përpunim të të dhënave.....	6
7. Ndarja e të dhënave personale të mbledhura.....	6
8. Të drejtat e palëve	7
9. E drejta e ankimit	7
10. Siguria e të dhënave personale.....	8
11. Përditësimi i Politikës së privatësisë	8
12. Përfundim.....	9

1. Hyrje

Sipas Ligjit nr. 08/I-110 Agjencia e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) është agjenci rregullatore në proceset dhe përgjegjësitë e akreditimit, riakreditimit, validimit, monitorimit dhe pasakreditimit që ka për qëllim sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. AKA ka mandat ligjor për të siguruar cilësinë në arsimin e lartë dhe për të përforcuar besueshmërinë e sistemit arsimor, afirmimin dhe ngritjen e kulturës së nivelit shoqëror duke u bazuar në standardet dhe praktiket më të mira ndërkombëtare, përfshirë Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG).

Ky dokument përshkruan politikat institucionale mbi të cilat mbështetet funksionimi i AKA-së, mënyrën se si përpunohen dhe mbrohen të dhënat personale të individëve dhe institucioneve që bashkëpunojnë me AKA.

Politika e privatësisë ka për qëllim të informojë për mënyrën se si AKA mbledh, përpunon, përdor, ruan dhe mbron të dhënat personale, si dhe të drejtat që garantohen në këtë proces.

2. Politikat e privatësisë

E drejta e privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave personale është ndër prioritetet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, që angazhohet të përpunojë të dhënat personale në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili është në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Politika e mbrojtjes së të dhënave personale është e zbatueshme nëse jeni aplikant për punë, aplikoni si palë në procesin e akreditimit, jeni palë kontraktuese, merrni pjesë në trajnime, vizitoni AKA-në, përdorni ndonjë shërbim, paraqitni kërkesa të ndryshme si qasja në dokumente publike, ankesë në formë elektronike apo në formë fizike përmes protokollit të AKA-së.

3. Përgjegjësia dhe përpunimi i të dhënave personale

AKA mbledh dhe përpunon të dhëna personale të individëve dhe institucioneve me qëllim të vlerësimit, akreditimit, monitorimit dhe procedurave pasakredituese, duke respektuar ligjin në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- 3.1. Drejtori i Përgjithshëm i AKA-së me vendim cakton zyrtarin përgjegjës i cili ka për obligim kujdesin për mbrojtjen e të dhënave personale të pranuar, përpunuara dhe të përdorura. Zyrtari përgjegjës raporton në mënyrë periodike lidhur me përmbushjen e obligimeve ligjore për zbatimin e politikave të privatësisë.
- 3.2. Zyrtari përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale në AKA mbanë kontakte të vazhdueshme me Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP) dhe bazuar në rekomandimet e AIP-së i raporton drejtpërdrejt Drejtorit të Përgjithshëm të AKA-së për nivelin e sigurisë së privatësisë, ankesat apo gjetjet eventuale nga organet kompetente për nivelin e ruajtjes së privatësisë dhe të dhënave personale në raportet AKA – palë të jashtme.

4. Kategoria e të dhënave të përpunuara

Kategoria e të dhënave të përpunuara përfshin të dhëna identifikuese, të dhëna profesionale dhe akademike, si dhe informacione që lidhen me përfshirjen në proceset e akreditimit.

4.1. Në varësi të qëllimeve dhe arsyeve specifike AKA përpunon të gjitha ose disa nga të dhënat personale të specifikuara më poshtë, ndaras ose në kombinim ndërmjet tyre:

4.1.1. Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, të dhënat e dokumentit të identitetit;

4.1.2. Të dhënat e kontaktit: adresa, email, numri i telefonit;

4.1.3. Të dhëna për arsimimin, kualifikimin profesional dhe veprimtarinë e punës, kontrata, thirrja akademike, deklarata nën betim, deklarata e konfidencialitetit dhe deklarata e shmangies së konfliktit të interesit;

4.2. Të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale:

4.2.1. Informacione dhe të dhëna personale të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore të AKA-së për të garantuar sigurinë në ofrimin e shërbimeve të procesit të vlerësimit të jashtëm, për të gjitha institucionet e arsimit të lartë;

4.2.2. Informacione për të dhëna financiare si: llogaria bankare, IBAN kodi dhe certifikata rezidenciale për tatimpagues.

4.2.3. Fotografi dhe video incizime nga konferenca, seminare dhe simpoziumet shkencore që ndërlidhen me aktivitetet publike të AKA-së.

5. Përdorimi i të dhënave personale

Agjencia e Kosovës për Akreditim përpunon të dhënat personale duke përmbushur detyrimet ligjore sipas Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian.

5.1. AKA mbrojtjen e të dhënave personale e adreson gjatë proceseve të akreditimit dhe proceseve të tjera, që zhvillohen brenda fushëveprimtarisë së saj, ku përfshihet:

- 5.1.1. Përmbushja e detyrimeve të organeve kompetente shtetërore;
- 5.1.2. Procedurat e rekrutimit, zhvillimi profesional dhe avancimi i stafit të AKA-së;
- 5.1.3. Lidhja e kontratave dhe marrëdhënieve parakontraktuale;
- 5.1.4. Garantimi i sigurisë së të dhënave personale të punonjësve, vizitorëve, si dhe infrastrukturës fizike të institucionit, përmes sistemit të mbikëqyrjes vizuale - video, kontrollit të qasjes dhe regjistrimit të vizitorëve;
- 5.1.5. Përpunimi i kërkesave sipas Ligjit NR.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- 5.1.6. Promovimi i aktiviteteve të AKA-së duke përfshirë shpërndarjen e materialeve dhe broshurave reklamuese, posterëve, postimin e fotove/videove në ueb faqe dhe në rrjetet sociale.

6. Baza ligjore për përpunim të të dhënave

Agjencia e Kosovës për Akreditim përpunon të dhënat personale të subjekteve në bazë të detyrimeve ligjore dhe funksioneve të saj, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me legjislacionin e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

- 6.1. Agjencia siguron që çdo përpunim të jetë i ligjshëm, sipas parimeve të mbrojtjes së privatësisë, proporcionalitetit dhe integritetit të të dhënave.
- 6.2. Palët e jashtme aplikojnë dhe dorëzojnë të dhënat personale të stafit akademik dhe administrativ për të realizuar kërkesat dhe objektivat e tyre.

7. Ndarja e të dhënave personale të mbledhura

Të dhënat personale të mbledhura nga AKA, mund të ndahen me autoritetet kompetente siç janë: Këshilli Shtetëror i Cilësisë, Komisioni i Ankesave, ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, institucionet e zbatimit të ligjit dhe stafi i AKA-së, vetëm për qëllime të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi dhe me masa të sigurta mbrojtjeje.

8. Të drejtat e palëve

Me rastin e përpunimit të të dhënave personale nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, brenda afateve të përcaktuara me Ligjin e AKA-së, palët kanë të drejtë në qasje të të dhënave të tyre personale, të kërkojnë korrigjimin ose përditësimin e tyre dhe fshirjen e të dhënave ose ndalimin e përpunimit në rrethana të caktuara.

Palët kanë të drejtën e ankesë në rast se konsiderojnë shkelje gjatë përpunimit të të dhënave të tyre personale, siç parashihet me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9. E drejta e ankimit

- 6.1. Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që pretendon se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale mund të paraqesë ankesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim në e – mail akreditimi@rks-gov.net ose leona.barbatovci@rks-gov.net, në formë elektronike apo edhe me shkrim përmes protokollit.
- 6.2. Agjencia e Kosovës për Akreditim bashkëpunon me organet kompetente dhe siguron trajtimin e çdo ankesë në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtën e subjekteve të të dhënave për mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.
- 6.3. Ankesat mund të dorëzohen edhe në Agjencinë për Informim dhe Privatësi në adresën: Rr. Zejnel Salihu Nr. 22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës, ose përmes mjeteve elektronike të komunikimit të AIP-së.
 - 6.3.1. E drejta për të paraqitur ankesë tek AIP, është e garantuar me nenin 52 të Ligjit Nr. 06/L - 082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në të cilin përcaktohet:
 - 9.3.3.1 Pa cenuar mjetet e tjera administrative ose gjyqësore të mbrojtjes, çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të paraqesë ankesë tek Agjencia, nëse subjekti i të dhënave pretendon se gjatë përpunimit të të dhënave personale, është shkelur ligji.
 - 9.3.3.2 Agjencia njofton ankuesin mbi progresin dhe rezultatin e ankesës, duke përfshirë mundësinë e një mjeti ankimi gjyqësor, në pajtim me nenin 54 të këtij ligji.

10. Siguria e të dhënave personale

Agjencia e Kosovës për Akreditim zbaton masat e duhura fizike, organizative, teknike dhe të sigurisë kibernetike, për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- 10.1. Të dhënat personale ruhen dhe përpunohen vetëm për sa kohë është e nevojshme për realizimin e qëllimeve për të cilat janë mbledhur, dhe kjo kohëzgjatje përcaktohet nga dispozitat ligjore përkatëse, përfshirë Ligjin për Arkivat Shtetërore dhe legjislacionin tjetër në fuqi që rregullon ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve dhe të dhënave personale.
- 10.2. Agjencia siguron gjithashtu kontroll të rregullt të sistemeve dhe procedurave për të parandaluar qasjen e paautorizuar, humbjen, ndryshimin ose shpërndarjen e të dhënave personale.

11. Përditësimi i Politikës së privatësisë

Agjencia e Kosovës për Akreditim mund të përditësojë periodikisht politikën e privatësisë për të reflektuar ndryshimet ligjore, rregullore ose praktika të reja në përpunimin e të dhënave personale.

- 11.1. Çdo ndryshim do të publikohet në ueb faqen zyrtare të AKA-së, duke siguruar që palëve t'u ofrohet informacion i qartë dhe i përditësuar mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të tyre.
- 11.2. Ueb faqja e AKA-së përmban lidhje (links) për ueb faqet e tjera. Për këto ueb faqe rekomandohet që të lexoni dhe njiheni me politikat e tyre të privatësisë, pasi që AKA nuk është përgjegjëse për përmbajtjen ose praktikën e privatësisë të këtyre ueb faqeve.

12. Përfundim

Politika e privatësisë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim reflekton përkushtimin institucional për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përputhjen me legjislacionin e Kosovës dhe atë të Bashkimit Evropian.

Dokumenti përshkruan qartë mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes dhe ndarjes së të dhënave personale të individëve dhe institucioneve që bashkëpunojnë me AKA.

Qëllimi kryesor është garantimi i sigurisë, transparencës dhe të drejtave të palëve gjatë proceseve të përpunimit të të dhënave, në funksion të detyrave të AKA-së për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Gjithashtu, AKA ka struktura të caktuara për mbikëqyrjen e përputhshmërisë me këto politika, përfshirë zyrtarin përgjegjës për privatësinë dhe bashkëpunimin me Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Me masa të qarta sigurie dhe mekanizma ankimimi të garantuar me ligj, politika e privatësisë kontribuon në ndërtimin e një ambienti të besueshëm dhe profesional për institucionet e arsimit të lartë dhe publikun në përgjithësi.

Zbatimi i këtyre politikave është i ndërlidhur ngushtë me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, pasi mbrojtja e të dhënave personale është komponent thelbësor në proceset e fushëveprimtarisë së AKA-së.